


## Statistikat Tregtare te Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Gjermaninë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) shkëmbimi tregtar me Gjermaninë<sup>1</sup>, në vitin 2025, deficitin tregtar ka shënuar një rritje prej 14.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur në -901.1 milionë euro nga -789.9 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti ka rënë në 10.6%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Gjermani sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	87.8	93.6	100.7	107.1
Import	610.4	682.6	890.5	1,008.3
Bilanci tregtar	(522.7)	(589.0)	(789.9)	(901.1)
% e mbulimit	14.4%	13.7%	11.3%	10.6%
Rritje Exp. (v-m-v) %	43.3%	6.6%	7.6%	6.4%
Rritje Imp. (v-m-v) %	0.6%	11.8%	30.5%	13.2%
Bila. Treg. (v-m-v) %	-4.2%	12.7%	34.1%	14.1%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

<sup>1</sup> Gjermania, zyrtarisht Republika Federale e Gjermanisë, është një vend në Evropën Perëndimore dhe Qendrore, me kryeqytet Berlin. Ka një sipërfaqe prej 357,022 km<sup>2</sup> me rreth 84 milion banor. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 5.05 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 59,925 \$ (dollar amerikan), e rënditur si ekonomia e tretë më të madhe në botë sipas FMN (IMF).

Analizuar në periudhën e fundit trevjeçare, eksportet e Kosovës drejt Gjermanisë janë rritur me një mesatare vjetore prej 6.8%, ndërsa importet kanë shënuar një rritje mesatare vjetore dukshëm më të lartë prej 18.5%, kjo tregon se blerjet nga Gjermania janë rritur mesatarisht pothuajse tri herë më shpejt sesa shitjet drejt saj. Hovin më të madh të thellimit të deficitit tregtar e ka pasur viti 2024 (me një rritje prej 34.1% të deficitit), kryesisht i nxitur nga një rritje e madhe prej 30.5% e importeve brenda atij viti.

Si rezultat i këtij trendi, i rritjes më të shpejtë të blerjeve (importeve), se sa të shitjeve (eksporteve), përqindja e mbulimit të importeve me eksporte, ka rënë në mënyrë të njëtrajtshme nga 14.4% sa ishte në vitin 2022, në vetëm 10.6% në vitin 2025.

Figura 2. Eksport/Importi me Gjermaninë sipas viteve në milion Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjermania nga viti në vit zë një vend të rëndësishëm në eksportin e Kosovës. Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara arrin në 107.1 milionë euro apo 11.4% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, renditet e treta në listën e 10 vendeve kryesore të eksportet.

Importi i mallrave nga Gjermania arritën në 1,008.3 milionë euro apo 14.1% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm, renditet e para në listën e 10 vendeve kryesore të importet.

## Struktura e Eksportit/Importit me Gjermani në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesor të Eksportit e përbëjnë: 23.7% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 19.7% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 17.7% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 10.1% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7.1% Produkte bimore; 6.6% Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike; 6.0% Tekstil dhe artikuj tekstili etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Gjermaninë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e eksporteve për 6.4% apo rreth 6.5 milionë euro më shumë mallra në tregun gjerman në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja te sektorët si, Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani (nga 8.1% në 10.1%), Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike (nga 3.7% në 6.6%) etj.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 59.0% Mjetet e transportit; 8.4% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 8.1% Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike; 7.0% Produkte të industrisë kimike; 6.1% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 3.6% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe, etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Gjermania.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open\_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 13.2% apo rreth 117.7 milionë euro më shumë mallra të importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve kyç si, Mjetet e transportit (nga 56.8% në 59.0%) dhe një rritje e lehtë të Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani (nga 8.2% në 8.4%).